**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 570/ 7 prot. Datë 03.05.2023

**V E N D I M**
**Nr. 337/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 05.05.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Albavia*" SHPK në lidhje me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022,* me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK si dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë "*Albavia*" SHPK, "*Pe-Vla-Ku*" SHPK, "*2T*" SHPK në procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022*, me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për tu zhvilluar në

datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022*, me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës në lidhje me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK në procedurën e prokurimit të mësipërcituar.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK
Adresa: Rruga "Rreshit Petrela", Kompleksi Usluga, Kt 8, Tiranë.

Operatori ekonomik "*Albavia"* SHPK
Adresa: Rruga "Sulejman Delvina", Pallati Fati, Shk.1, Ap.19, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Pogradec.
Adresa: Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagja Nr 2, Pogradec.

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik "*Pe-vla-ku"* SHPK
Adresa: Rruga "Muzaket", Pallatet "Vokshi", Hyrja 1, Kati. 7, Tiranë.

Operatori ekonomik "*2T*" SHPK
Adresa: Rruga "Asim Vokshi", Nd.14, H.4, Ap.5, Tiranë.

Operatori ekonomik "*Salillari*" SHPK
Adresa: Lagjja "Vore", Rruga e Vjetër, Vorë, Marikaj, Km 1, Godina katër katëshe, Kati i tretë, Nr.5, Vorë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022*, me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e*

*treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 02.11.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 05.12.2022 autoriteti kontraktor me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka njoftuar operatorin ekonomik "*Albavia*" SHPK si më poshtë vijon:

*Kërkesë për dorëzim të dokumentacionit fizik*

*Në mbështetje të LPP dhe rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik "Albavia" SHPK është renditur i pari gjatë kualifikimit. Për këtë arsye, lutemi të dorëzoni dokumentacionin fizik ashtu siç kërkohet në LPP Brenda 5 (Pesë) ditëve pranë autoritetit kontraktor.*

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se me shkresën nr. 14714/12 prot, datë 09.12.2022 operatori ekonomik "*Albavia*" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin pranë autoritetit kontraktor në zbatim të kërkesës së autoritetit kontraktor të datës 05.12.2022 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Në datën 25.01.2023 autoriteti kontraktor me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka njoftuar operatorin ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK si më poshtë vijon:

*Kërkesë për dorëzim të dokumentacionit fizik*

*Në mbështetje të LPP dhe rregullave të prokurimit publik, duke qenë se ju jeni kualifikuar në vend të parë në vlerësimin e ofertave, jeni të lutur të dorëzoni pranë autoritetit tonë kontraktor, dokumentacionin fizik ashtu sic kërkohet në DST, brenda 5 (Pesë) ditëve nga marrja e kësaj kërkese.*

II.6. Në datën 16.12.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1. | "Albavia" SHPK | 153,876,474.78 | lekë | skualifikuar |
| 2. | "Pe-Vla-Ku" SHPK | 171,719,233.80 | lekë | kualifikuar |
| 3. | "2T" SHPK | 187,369,889.40 | lekë | kualifikuar |
| 4. | "Alko Impex General Construction" SHPK | 192,578,543.88 | lekë | kualifikuar |
| 5. | "Salillari" SHPK | 195,845,297.82 | lekë | kualifikuar |

II.7. Në datën 16.12.2022 "*Albavia*" SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*1- Nga Operatori ekonomik "ALBAVIA" ShPK, me Nipt J81527001Q, nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, siç kërkohen në DST.*
*Konkretisht, Ne Piken 2.3.9 Te DST:*
*1 Mjeti me numer shasie 6498 Volvo L120, i deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur.*
*2- Per Kamioncinen me targe TR5481P, nuk ka paraqitur certificate pronesie.*
*3- Per Kamioncinen me targe TR5569P, nuk ka paraqitur certificate pronesie.*
*4- Per Fabriken e Asfaltobetonit S/N 1872, nuk ka paraqitur asnje dokument. Për sa më sipër, oferta e OE-së "Albavia" ShPK, rezulton e pavlefshme.*
II.8. Në datën 23.02.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | "Albavia" SHPK | 153,876,474.78 lekë skualifikuar |
| 2. | "Pe-Vla-Ku" SHPK | 171,719,233.80 lekë skualifikuar |
| 3. | "2T" SHPK | 187,369,889.40 lekë skualifikuar |
| 4. | "Alko Impex General Construction" SHPK | 192,578,543.88 lekë skualifikuar |
| 5. | "Salillari" SHPK | 195,845,297.82 lekë skualifikuar |

II.9. Në datën 23.02.2023 "*Alko Impex General Construction*" SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*Nga OE "Alko-Impex General Construction" ShPK nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST, konkretisht:*

***1.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Shoqeria ka paraqitur 10 shoferet e kerkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plote sepse mungonte certifikata nga ISHT-I per secilin prej tyre.*

***2.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Per 6 manovratoret e kerkuar nuk eshte paraqitur certifikata nga ISHT-i.*

***3.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", OE ofertues ne oferten e tij eshte mbeshtetur me dokumentacion ne kapacitetet e operatorit "Alko Impex Construction" shpk per 3 teknike*

*ndertimi dhe 3 manovratore, per te cilet nuk jane paraqitur listepagesat e kerkuara per periudhen korrik-shtator 2022, per te verifikuar punonjesit e paraqitur nga kjo shoqeri.*

***4.** Nga shoqeria mbeshtetese "Alko Impex" shpk, nuk jane paraqitur listepagesat e kerkuara per periudhen korrik-shtator 2022, per te verifikuar punonjesit e paraqitur nga kjo shoqeri (teknike ndertimi + manovratore", te cilet do te mbeshtesin OE ofertues "Alko-Impex General Construcion".*

***5.** Nuk jane paraqitur Deshmite e penalitetit per personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administrator apo drejtues te shoqerise (sipas shtojces nr. 8).*

***6.** Ne piken 2.3.9 "Makineri dhe Pajisje", Per makinerite e kerkuara nuk eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i kerkuar sipas DST. Konkretisht :*

- *Kamionçina me targa AA618GM, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;*
- *Kamiomçina me targa AA675PI, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;*
- *Kamioni me targë AA93500, polica e sigurimit e skaduar me date 24.11.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*
- *Kamioni me targë AA5I9RZ, çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*
- *Kamioni me targë AA4I2VO, me siguracion të skaduar ne date 02.12.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*
- *Kamioni me targë AA125OV me siguracion të skaduar me date 02.12.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 17.12.2022;*

- *Autobitrumatriçe AA72IXG me çertifikatë te kontrollit teknik të skaduar me date 21.12.2022;*
- *Mjetet eskavator me goma, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi nderkohe qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë" si dhe Ligji Nr. 32/2021 "Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit" parashikojne se, "mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim , cdo mjet me goma i levizshem duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi" si dhe "Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti".*

*- Mjeti Grejder, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi nderkohe qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë" si dhe Ligji Nr. 32/2021 "Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit" parashikojne se, "mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim, cdo mjet me goma i levizshem duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi" si dhe "Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti".*

*Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE "Alko - Impex General Construcion" shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.*

II.10. Në datën 10.03.2023 është Publikuar Njoftim Anulimi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe në buletinin nr. 24 të datës 13.03.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.10. Në datën 15.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 561 prot, datë 15.03.2023 e operatorit ekonomik "*Albavia*" SHPK, me anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.10.1. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 562/2 prot., datë 15.03.2023 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues "*Albavia*" SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 562 prot, datë 15.03.2023.

II.10.2. Me shkresën nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 protokolluar me tonën me nr. 561/3 prot datë 27.03.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor në lidhje me arsyet e skualifikimit si dhe informacion lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues "*Albavia*" SHPK e cila më vendimin nr. 1144/3 prot, datë 24.03.2023 ka vendosur pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Në datën 15.03.2023 ankesa e OE "Albavia" shpk protokollohet pranë Koinisionit të Prokurimit Publik me nr. 561/2023 Prot. dhe pasqyrohet tek ankesa ne shqyrtim ne faqen zyrtare te KPP, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-ankiini.*

*OE "Albavia" shpk në procedurën e prokurimit ka paraqitur argumentat e tij si më poslitë vijon:*
*Lidhnr me pikën I te skualifikimit. "Mjeti me numer shasie 6498 Volvo L120, i deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur".*

*OE ankimues "ALBAVIA" shpk, me Nipt J81527001O, pretendon se ndryshe nga sa eshte konstatuar nga AK Bashkia Pogradec, lidhur me refuzimin e ofertes se paraqitur, OE e kundershton skualifikimin e ofertes se tij ekonomike pasi pretendon se eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i plote dhe i sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te DST: 2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

| *NR* | *EMERTIMI I MAKINERIVE* | *NJESIA* | *SASIA* | *ME QERA/PRONESI* |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *SKREPER* | *Cope* | *1* | *ME QERA/PRONESI* |

*KSHA veren se: Pas verifikimit te dokumentacionit fizik te paraqitur prane AK me shkresen nr. 4714/12, date 09.012.2022, me lende "Shkrese percjellese dokumentacioni provoues, pretendimet e OE ankimues qendrojne seose dokumentacioni i kerkuar nga AK, lidhur me kerkesat per kualifikim te pikes 2.3.9 te DST, perkatesisht per mjetin Skreper, ashtu si pretenon OE ankimues ne formularin e Vetdeklarimit, permbushet me dokumentat e meposhtme:*

- *Fature Tatimore Shitje, nr. 29, date 26.11.2015 ne te cilen evidentohet blerja nga Albavia e Traktor tip Katerpilar me numer 48A7695, Skreper per vleren me tvsh 665279 leke.*
-
- *Rul tip Bomag*
-
- *Rul Ngjeshes me nr. Shasie 16285237*
-
- *Kontrate shitje nr. 1126 rep/192 kol datë 16.02.2005 në të cilen evidentohet blerja e nje eskavatori, model JCB SALES 1 CXHF-P, nr. Shasie 0752122, së cilës I bashkangjitet: a) Vertetim zhdoganimi date 09.12.2004; b) Leja qarkullimit (italiane) date 23.09.2004; c) Fatura date 30.11.2004 e blerjes prej shitesit.*

- *Fature Blerje date 20.04.1999 Fadrome Volvo L120, se ciles I bashkangjitet: a) Vërtetimi zhdoganimit; b) Deklarata Doganore; c) Foto e mjetit.*

*KSHA konstaton se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) në vlerësimin e këtij kriteri, i është referuar vetëm faturës së blerjes date 20.4.99, per Fadrome VOLVO L120 dhe nuk ka konstatuar pranine e 2 dokumentacioneve te tjera, të cilat vertetojnë faktin se OE ka paraqitur mjetin Skreper te kërkuar.*

*Lidhur me Piken II te skualifikimit: OE ankimues "ALBAVIA" shpk, pretendon se skualifikimi eshte i padrejte meqenese nga AK Bashkia Pogradec nuk eshte kerkuar ne kriter paraqitja e certifikatave te pronesise. OE eshte skualifikuar me arsyetimin:*

1. *Per Kamioncinen me targe TR5481 P, nuk ka paraqitur certifikate pronesie,*

*2. Per Kamioncinen me targe TR5569 P, nuk ka paraqitur certifikate pronesie,*

*KSHA konstaton se, kriteri i vendosur në DST nuk nënkupton në asnje rast se OE ofertues duhet të paraqesin certifikatat e pronësisë se mjeteve, si më poshtë:*

*2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e meposhtme teknike që nevojiten per ekzekutimin e kontrates:*

| *NR* | *EMERTIMI I MAKINERIVE* | *NJESIA* | *SASIA* | *ME QERA/PRONESI* |
|---|---|---|---|---|
| *7* | *KAMIONCINE* | *Cope* | *3* | *ME QERA/PRONESI* |

***a)*** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*

***b)*** *Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënësit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.*

*KSHA mendon se, duke ju permbajtur percaktimit në DST, lidhur me kete kusht duke qene se OE ankimues "Albavia" SHPK ka paraqitur dokumentat provuese të cituara me larte me te drejte pretendon se ky arsyetim skualifikimi nuk qendron dhe KVO ne vleresimin e ofertes duhet te ishte permbajtur vetem dokumentave te kerkuara provouese.*

*Lidhur me Pikën III të skualifikimit: OE ankimues "Albavia" SHPK, pretendon se dokumentacioni i paraqitur per plotesimin e pikes 2.3.9 te DST per fabriken e asfaltobetonit S/N 1872 është dokumentacioni i plotë dhe i rregullt ligjor për te vertetuar se OE i permbush kriteret e vendosura nga AK. Ndryshe nga sa eshte konstatuar nga AK Bashkia Pogradec (OE nuk ka paraqitur asnje dokument per Fabriken e Asfaltobetonit), per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te DST, Albavia shpk ka deklaruar sipas shtojces 8 se Fabriken e Asfaltobetonit e ka me nr. S/N: 1872 dhe me karakteristika te tjera te llojit ËASY BATCH" dhe per te provuar kete fakt ka depozituar prane AK dokumentacionin e meposhtem:*

- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 A6411, lloji "Semitrajler per prodhim asfalti".*
- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 / 1109, lloji "Makinat per Perzierjen e substancave minerale dhe bitumi, Trajlera te levizshem per prodhim asfalti" 2 cope.*
- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 / F6557, lloji "Pjese te linjes se asfaltit depozita 60 m3" 1 cope.*

- *Fature Nr. 58/2009 datë 10.04.2009, me pershkrimin "Nje njesi depozite bitumi horizontale e jashtme".*
- *Fature Nr. 52/2009 datë 07.04.2009, me pershkrimin "Nje fabrike asfalti sic e specifikuar ne kontraten date 23.03.2009".*
- *Foto te fabrikes se Asfaltit tipi Easy Batch.*
- *Leje Mjedisore PN-7952-09-2014 e tipit B me objekt: Veprimtari që përfshijnë ngrohjen por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi".*
- *Akt miratimi Leje Mjedisi Tipi B, me numër identifikimi te Lejes 1704, date 16.09.2014.*

*KSHA veren se: Nga verifikimi i dokumentave fizike të paraqitura pranë AK me shkresën nr. 4714/12, date 09.12.2022, me lende "Shkrese percjellese dokumentacioni provues", pretendimet e OE ankimues qendrojne, pasi dokumentacioni i kerkuar nga AK lidhur me kerkesat per kualifikim te pikes 2.3.9 te DST lidhur me fabriken e Asfaltobetonit jane paraqitur te inventarizuara tek seksioni i dokumentacionit te makinerive qe perbehet nga 422 flete te inventarizuara dhe pikerisht ne fatet 303-342.*
*Kjo pike e DST kerkon saktesisht 2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: e) Për Fabrikën e asfaltobetonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates".*

*KSHA konstaton se duke ju referuar kriterit te kerkuar nga AK, OE ankimues ka arritur te vertetoje se dipsponon Fabriken e Asfaltobetonit me ane te dokumentacionit te depozituar prane AK. Paraqitja e dokumentacionit te sipercituar nga "Albavia" SHPK tregon qarte se ai zoteron kete fabrike, vetem me fatura blerje, deklarata doganore si dhe me Lejen Mjedisore per kete veprimtari….*

*Për sa me sipër, në mbeshtetje të nenit 92/3 të LPP: ". Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin OE per permbushjen e ketyre kritereve". Gjithashtu referuar kriterit te vendosur ne DST: Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara. Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim". KSHA-ja vlereson se OE "Albavia" SHPK eshte skualifikuar ne menyre te padrejte dhe keto arsye skualifikiminuk qendrojne.*

*Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës , KSHA-ja në mbështetje te nenit 110 të ligj it nr. l 62/2020 "Për prokurimin Publik" dhe nenit 97 tr VKM-se nr. 255, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,*

*Vendos:*

*1. Të pranojë ankesen e operatorit ekonomik "ALBAVIA" shpk me Nr J81527001O, si nje ankesë te drejte dhe të mbështëtur në LPP dhe në Regullat e Prokurimit Publik.*

*2. Për këtë vendim te njoftohet menjehere Komisioni Prokurimit Publik.*

III.11. Në datën 23.02.2023 "*Alko Impex General Construction*" SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*Nga OE "Alko-Impex General Construction" shpk nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST, konkretisht:*

***1.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Shoqeria ka paraqitur 10 shoferet e kerkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plote sepse mungonte certifikata nga ISHT-I per secilin prej tyre.*

***2.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", Per 6 manovratoret e kerkuar nuk eshte paraqitur certifikata nga ISHT-i.*
***3.** Ne piken 2.3.7 te DST "Stafi Teknik", OE ofertues ne oferten e tij eshte mbeshtetur me dokumentacion ne kapacitetet e operatorit "Alko Impex Construction" shpk per 3 teknike ndertimi dhe 3 manovratore, per te cilet nuk jane paraqitur listepagesat e kerkuara per periudhen korrik-shtator 2022, per te verifikuar punonjesit e paraqitur nga kjo shoqeri.*

***4.** Nga shoqeria mbeshtetese "Alko Impex" shpk, nuk jane paraqitur listepagesat e kerkuara per periudhen korrik-shtator 2022, per te verifikuar punonjesit e paraqitur nga kjo shoqeri (teknike ndertimi + manovratore", te cilet do te mbeshtesin OE ofertues "Alko-Impex General Construcion".*

***5.** Nuk jane paraqitur Deshmite e penalitetit per personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administrator apo drejtues te shoqerise (sipas shtojces nr. 8).*

***6.** Ne piken 2.3.9 "Makineri dhe Pajisje", Per makinerite e kerkuara nuk eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i kerkuar sipas DST. Konkretisht :*

*- Kamionçina me targa AA618GM, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;*

*- Kamiomçina me targa AA675PI, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;*

*- Kamioni me targë AA93500, polica e sigurimit e skaduar me date 24.11.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*

*- Kamioni me targë AA5I9RZ, çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*

*- Kamioni me targë AA4I2VO, me siguracion të skaduar ne date 02.12.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;*

*- Kamioni me targë AA125OV me siguracion të skaduar me date 02.12.2022 dhe çertifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 17.12.2022;*

*- Autobitrumatriçe AA72IXG me çertifikatë te kontrollit teknik të skaduar me date 21.12.2022;*

*- Mjetet eskavator me goma, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi nderkohe qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë" si dhe Ligji Nr. 32/2021 "Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit" parashikojne se, "mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim , cdo mjet me goma i levizshem duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi" si dhe "Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti".*

*- Mjeti Grejder, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi nderkohe qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë" si dhe Ligji Nr. 32/2021 "Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit" parashikojne se, "mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim, cdo mjet me goma i levizshem duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi" si dhe "Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti".*

*Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE "Alko - Impex General Construcion" shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.*

II.11.1. Në datën 10.03.2023 është Publikuar Njoftim Anulimi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe në buletinin nr. 24 të datës 13.03.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.11.2. Në datën 16.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 570 prot e operatorit ekonomik "*Alko-Impex General Construction*" SHPK me anë të së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga kjo procedurë prokurimi si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët e tjerë pjesëmarrës.

II.11.3. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b)

të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 570/3 prot., datë 20.03.2023 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues "*Alko-Impex General Construction"* SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 570 protokolli, datë 16.03.2023, si pretendimet mbi mospërmbushjen e kritereve nga operatorët e tjerë pjesëmarrës "*Albavia*" SHPK, "*Pevlaku*" SHPK dhe "*2T*" SHPK.

II.11.4. Me shkresën Nr. 570/4 prot., datë 29.03.2023 me objekt "*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Alko-Impex General Construction"* SHPK, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor, Bashkia Pogradec, duke i kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e arsyeve të skualifikimit të dorëzuar nga operatori ekonomik "*Alko-Impex General Construction"*" SHPK, sipas kërkesës së bërë nga ana e autoritetit kontraktor më datë 07.02.2023, në lidhje me vërtetueshmërinë e kritereve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.
II.11.5. Me shkresën nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 570/6 prot datë 06.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dsipozicion të Komisionit Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "*Alko-Impex General Construction"* SHPK lidhur me vërtetueshmërinë e e kritereve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *"Alko-Impex General Construction*" SHPK e cila ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues konkretisht vetëm për pikën IV të arsyes së skualifikimit si më poshtë vijon:

*[.....] Lidhur nie Pikën IV të skualifikimit: 4. Nuk janë paraqitur Deshmite e penalitetit per personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administratorit apo drejtues të shoqërisë (sipas shtojces nr. 8). OE ankimues "ALKO-IMPEX General Construction" shpk, pretendon se ky skualifikim është i padrejtë pasi nga OE ankimues është paraqitur shtojca nr. 8, në përmbushje të kritereve kualifikuese, sipas përmbajtjes së kërkuar nga AK në DST. Në nenin 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në keto rregulla. Në interpretim të paragrafit të mësipërm, KSHA e konsideron të përmbushur kriterin e kushteve të përgjithshme të kualifikimit vetëm me paraqitjen e shtojcës nr. 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", duke i qëndruar strikt parashikimit të nenit 26, pika 6 të VKM nr. 285, e cila thotë se: 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kulalifikuar, i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të*

*këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion ose atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Për sa më sipër, KSHA e pranon këtë pretendim pasi në nënin e sipërcituar përjashtohet paraqitja e dokumentacionit për shkronjën C të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 255. (personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerët ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së [.....].*

II.17. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 570/4 prot, datë 24.03.2023 nga operatori ekonomik i interesuar "Albavia" SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*".

## III
## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Albavia*" SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyet se: "*1- Nga Operatori ekonomik "ALBAVIA" ShPK, me Nipt J81527001Q, nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, siç kërkohen në DST. Konkretisht, Ne Piken 2.3.9 Te DST: 1 Mjeti me numër shasie 6498 Volvo L120, I deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur. 2- Per Kamioncinen me targe TR5481P, nuk ka paraqitur certificate pronesie. 3- Per Kamioncinen me targe TR5569P, nuk ka paraqitur certificate pronesie. 4- Per Fabriken e Asfaltobetonit S/N 1872, nuk ka paraqitur asnje dokument. Për sa më sipër, oferta e OE-së "ALBAVIA" shpk, rezulton e pavlefshme.".* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*" në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________të operatorit ekonomik

______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | -------------------------------------------------- - |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | -------------------------------------------------- ---- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | -------------------------------------------------- --- |
| E-mail: | -------------------------------------------------- -------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

**(nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

**TË KUALIFIKIMIT**

| Deklarata | Referencat (kur janë të zbatueshme) |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentacit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>________________<br>________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]] |

| | |
|---|---|
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

| | |
|---|---|
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br><br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br><br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br><br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: | ___________________________ |
| 1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate; | Po [ ] |
| 2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet; | Po [ ] |
| 3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit; | Po [ ] |
| 4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit; | Po [ ] |
| 5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:<br>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;<br><br>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës . | Po [ ] |
| 6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër; | Po [ ] Jo [ ] |
| 7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit). | |
| 8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :<br>a) çmimet;<br>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose<br>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës. | Po [ ] Jo [ ] |
| 9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose këërkesat specifike të punëëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |
| 10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |

C**: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të |

përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
| --- | --- |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| 1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. | Po [ ] Jo [ ] |
| | |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"**

| Deklarata | Përgjigje |
| --- | --- |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | |
| | |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>**Shënim**: nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:<br><br>Operatori ekonomik ____________________, do të mbështet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës ______________________, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse:_________, _________, __________ (nëse është rasti). | **Punonjës**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve<br><br>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br><br>1. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br>2. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br>3. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br><br>**Makineri e mjete**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË "Për disponimine mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)** |
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | | | | |

| **Kontratë furnizimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont sëfurnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

| | |
|---|---|
| Deklarata | Përgjigje |

| | |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj[1] nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. | |
| Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:<br><br>Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>etj .,<br><br>i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. | |

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Firma ________________________**

**Vula_________________**

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të Informacionittë deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

III.1.2. Në shtojcën 7/2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*" pika 2.3.9 "*Kapaciteti teknik*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

***2.3.9.*** *Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

| NR | EMERTIMI I MAKINERIVE | NJESIA | SASIA | ME QERA/PRONESI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | SKREPER | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 2 | ESKAVATOR 0.15 m3 | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 3 | ESKAVATOR ZINXHIR 0.5 m3 | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 4 | ESKAVATOR 0.5 m3 | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 5 | ESKAVATOR 1 m3 | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 6 | AUTOVETËSHKARKUES MBI 8 TON | Cope | 6 | ME QERA/PRONESI |
| 7 | KAMIONCINË | Cope | 3 | ME QERA/PRONESI |
| 8 | GREJDER | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 9 | RUL ME VIBRIM | Cope | 7 | ME QERA/PRONESI |
| 10 | AUTOBOT | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 11 | RUL ME KOMPRESOR | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 12 | AUTOBITUMATRICE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 13 | ASFALTOSHTRUESE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 14 | BETONIERE 500 LITRA | Cope | 4 | ME QERA/PRONESI |
| 15 | VINC KULLE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |

[1]Kjo deklaratë ka si qëllim garantimin e disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës objekt prokurimi sipas kërkesave të makinerive në DST

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 16 | VIBRATOR THELLESIE | Cope | 4 | ME QERA/PRONESI |
| 17 | FABRIKE ASFALTOBETONI | Cope | 1 | ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi |
| 18 | NYJE INERTESH | Cope | 1 | ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi |

**a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*

**b)** *Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e qiradhënësit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.*

**c)** *Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 8.*

**d)** *Per Nyjen e materialeve inerte, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine, Ne rast se eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se nuk ka ne pronesi apo me qera Nyje te materialeve inerte duhet te paraqitet kontrata noteriale e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

**e)** *Për Fabrikën e asfaltobetonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në*

*rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

III.1.3. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023, protokolluar me tonën me nr. 561/3 prot datë 27.03.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Albavia" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi tërësisht i ankesës si më poshtë vijon:

*Në datën 15.03.2023 ankesa e OE "Albavia" ShPK protokollohet pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 561/2023 Prot. dhe pasqyrohet tek ankesa ne shqyrtim ne faqen zyrtare te KPP, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-ankiini.*

*OE "Albavia" ShPK në procedurën e prokurimit ka paraqitur argumentet e tij si më poshtë vijon:*
*Lidhur me pikën I te skualifikimit. "Mjeti me numer shasie 6498 Volvo L120, i deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur".*

*OE ankimues "ALBAVIA" ShPK, me Nipt J81527001O, pretendon se ndryshe nga sa eshte konstatuar nga AK Bashkia Pogradec, lidhur me refuzimin e ofertes se paraqitur, OE e kundershton skualifikimin e ofertes se tij ekonomike pasi pretendon se eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i plote dhe i sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te DST: 2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

| *NR* | *EMERTIMI I MAKINERIVE* | *NJESIA* | *SASIA* | *ME QERA/PRONESI* |
|---|---|---|---|---|
| *1* | *SKREPER* | *Cope* | *1* | *ME QERA/PRONESI* |

*KSHA veren se: Pas verifikimit te dokumentacionit fizik te paraqitur prane AK me shkresen nr. 4714/12, date 09.012.2022, me lende "Shkrese percjellese dokumentacioni provoues, pretendimet e OE ankimues qendrojne seose dokumentacioni i kerkuar nga AK, lidhur me kerkesat per kualifikim te pikes 2.3.9 te DST, perkatesisht per mjetin Skreper, ashtu si pretenon OE ankimues ne formularin e Vetdeklarimit, permbushet me dokumentat e meposhtme:*

- *Fature Tatimore Shitje, nr. 29, date 26.11.2015 ne te cilen evidentohet blerja nga Albavia e Traktor tip Katerpilar me numer 48A7695, Skreper per vleren me tvsh 665279 leke.*
- *Rul tip Bomag*

- *Rul Ngjeshes me nr. Shasie 16285237*
- *Kontrate shitje nr. 1126 rep/192 kol datë 16.02.2005 në të cilen evidentohet blerja e nje eskavatori, model JCB SALES 1 CXHF-P, nr. Shasie 0752122, së cilës I bashkangjitet: a) Vertetim zhdoganimi date 09.12.2004; b) Leja qarkullimit (italiane) date 23.09.2004; c) Fatura date 30.11.2004 e blerjes prej shitesit.*
- *Fature Blerje date 20.04.1999 Fadrome Volvo L120, se ciles I bashkangjitet: a) Vërtetimi zhdoganimit; b) Deklarata Doganore; c) Foto e mjetit.*

*KSHA konstaton se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) në vlerësimin e këtij kriteri, i ështe referuar vetëm faturës së blerjes date 20.4.99, per Fadrome VOLVO L120 dhe nuk ka konstatuar pranine e 2 dokumentacioneve te tjera, të cilat vertetojnë faktin se OE ka paraqitur mjetin Skreper te kërkuar.*

*Lidhur me Piken II te skualifikimit: OE ankimues "ALBAVIA" shpk, pretendon se skualifikimi eshte i padrejte meqenese nga AK Bashkia Pogradec nuk eshte kerkuar ne kriter paraqitja e certifikatave te pronesise. OE eshte skualifikuar me arsyetimin:*

1. *Per Kamioncinen me targe TR5481 P, nuk ka paraqitur certifikate pronesie,*
2. *Per Kamioncinen me targe TR5569 P, nuk ka paraqitur certifikate pronesie,*

*KSHA konstaton se, kriteri i vendosur në DST nuk nënkupton në asnje rast se OE ofertues duhet të paraqesin certifikatat e pronësisë se mjeteve, si më poshtë:*

*2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e meposhtme teknike që nevojiten per ekzekutimin e kontrates:*

| *NR* | *EMERTIMI I MAKINERIVE* | *NJESIA* | *SASIA* | *ME QERA/PRONESI* |
|---|---|---|---|---|
| *7* | *KAMIONCINE* | *Cope* | *3* | *ME QERA/PRONESI* |

- ***c)*** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- ***d)*** *Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënësit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.*

*KSHA mendon se, duke ju permbajtur percaktimit në DST, lidhur me kete kusht duke qene se OE ankimues "Albavia" SHPK ka paraqitur dokumentat provuese të cituara me larte me te*

*drejte pretendon se ky arsyetim skualifikimi nuk qendron dhe KVO ne vleresimin e ofertes duhet te ishte permbajtur vetem dokumentave te kerkuara provouese.*

*Lidhur me Pikën III të skualifikimit: OE ankimues "Albavia" SHPK, pretendon se dokumentacioni i paraqitur per plotesimin e pikes 2.3.9 te DST per fabriken e asfaltobetonit S/N 1872 është dokumentacioni i plotë dhe i rregullt ligjor për te vertetuar se OE i permbush kriteret e vendosura nga AK. Ndryshe nga sa eshte konstatuar nga AK Bashkia Pogradec (OE nuk ka paraqitur asnje dokument per Fabriken e Asfaltobetonit), per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te DST, Albavia shpk ka deklaruar sipas shtojces 8 se Fabriken e Asfaltobetonit e ka me nr. S/N: 1872 dhe me karakteristika te tjera te llojit ËASY BATCH" dhe per te provuar kete fakt ka depozituar prane AK dokumentacionin e meposhtem:*

- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 A6411, lloji "Semitrajler per prodhim asfalti".*
- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 / 1109, lloji "Makinat per Perzierjen e substancave minerale dhe bitumi, Trajlera te levizshem per prodhim asfalti" 2 cope.*
- *Deklarate zhdoganimi, nr. Referimi 2009 / F6557, lloji "Pjese te linjes se asfaltit depozita 60 m3" 1 cope.*
- *Fature Nr. 58/2009 datë 10.04.2009, me pershkrimin "Nje njesi depozite bitumi horizontale e jashtme".*
- *Fature Nr. 52/2009 datë 07.04.2009, me pershkrimin "Nje fabrike asfalti sic e specifikuar ne kontraten date 23.03.2009".*
- *Foto te fabrikes se Asfaltit tipi Easy Batch.*
- *Leje Mjedisore PN-7952-09-2014 e tipit B me objekt: Veprimtari që përfshijnë ngrohjen por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi".*
- *Akt miratimi Leje Mjedisi Tipi B, me numër identifikimi te Lejes 1704, date 16.09.2014.*

*KSHA veren se: Nga verifikimi i dokumentave fizike të paraqitura pranë AK me shkresën nr. 4714/12, date 09.12.2022, me lende "Shkrese percjellese dokumentacioni provues", pretendimet e OE ankimues qendrojne, pasi dokumentacioni i kerkuar nga AK lidhur me kerkesat per kualifikim te pikes 2.3.9 te DST lidhur me fabriken e Asfaltobetonit jane paraqitur te inventarizuara tek seksioni i dokumentacionit te makinerive qe perbehet nga 422 flete te inventarizuara dhe pikerisht ne fatet 303-342.*
*Kjo pike e DST kerkon saktesisht 2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: e) Për Fabrikën e asfaltobetonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates".*

*KSHA konstaton se duke ju referuar kriterit te kerkuar nga AK, OE ankimues ka arritur te vertetoje se dipsponon Fabriken e Asfaltobetonit me ane te dokumentacionit te depozituar prane AK. Paraqitja e dokumentacionit te sipercituar nga "Albavia" SHPK tregon qarte se ai zoteron kete fabrike, vetem me fatura blerje, deklarata doganore si dhe me Lejen Mjedisore per kete veprimtari….*

*Për sa me sipër, në mbeshtetje të nenit 92/3 të LPP: “. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin OE per permbushjen e ketyre kritereve”. Gjithashtu referuar kriterit te vendosur ne DST: Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara. Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim”. KSHA-ja vlereson se OE “Albavia” SHPK eshte skualifikuar ne menyre te padrejte dhe keto arsye skualifikiminuk qendrojne.*

*Në përfundim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës , KSHA-ja në mbështetje te nenit 110 të ligj it nr. l 62/2020 “Për prokurimin Publik” dhe nenit 97 tr VKM-se nr. 255, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,*

*Vendos:*

*1. Të pranojë ankesen e operatorit ekonomik “ALBAVIA” shpk me Nr J81527001O, si nje ankesë te drejte dhe të mbështetur në LPP dhe në Regullat e Prokurimit Publik.*

*2. Për këtë vendim te njoftohet menjehere Komisioni Prokurimit Publik.*

II.1.4. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*
*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*
*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*
*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*
*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*
*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*
*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.6. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Albavia*" në ankesën nr. 561 prot, datë 15.03.2023, janë pranuar tërësisht nga ana e autoritetit kontrator Bashkia Pogradec konkretisht me vendimin nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 konkretisht nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor me kërkesë të këtij të fundit në lidhje me vërtetueshmërine e kritereve të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në përfundim, të shqyrtimit të dokumentacionit dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, komisioni shqyrtimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankimues "Albavia" SHPK me anë të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor i përmbush kriteret për të cilat është skualifikuar nga komisioni vlerësimit të ofertave, ndaj me vendimin nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 ka vendosur pranimin e ankesës së këtij operatori ekonomik. KPP nga sa më sipër konstaton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues "*Albavia*" SHPK është pranuar tërësisht duke arritur qëllimin e tij në këtë procedurë prokurimi duke u kualifikuar, ndaj për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes, dhe autoriteti kontraktor duhet të rivlersojë procedurën e prokurimit objekt ankimi në zbatim të vendimit të KSHA-së nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023, duke kualifikuar operatorin ekonomik ankimues "*Albavia*" SHPK, si rrejdhojë e pranimit të pretendimeve të ankimuesit në ankesën nr. 561 prot, datë 15.03.2023. Në këtë kuptim KPP gjykon se qëllimi i përdorimit të instrumentit të ankimimit nga ana e operatorit ekonomik ankimues si një operator ekonomik i interesuar dhe i legjitimuar për të bërë ankesë është përmbushur si rrjedhojë e pranimit të ankesës, ndaj dhe KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes objekt ankimi në përputhje me nenin 115 pika 3 gërma "b" e ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*".

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construction*" SHPK për sa i përket arsyes së skualifikimit se: "*Nuk janë paraqitur Dëshmitë e penalitetit për personat e deklaruar në Formularin e deklarimit si aksioner, administrator apo drejtues të shoqërise (sipas shtojcës nr. 8).",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit"* në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari ______________ në cilësinë e ________________të operatorit ekonomik

 _____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------<br>- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | --------------------------------------------------<br>---- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | --------------------------------------------------<br>--- |
| E-mail: | --------------------------------------------------<br>-------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

**(nëse është e zbatueshme)**

| |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| Deklarata | Referencat (kur janë të zbatueshme) |
|---|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: |

| | |
|---|---|
| vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. | Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentacit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>________________<br>________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: |

| | |
|---|---|
| për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. | Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

| | |
|---|---|
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br><br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br><br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br><br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br><br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: | ___________________________ |
| 11. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate; | Po [ ] |
| 12. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet; | Po [ ] |
| 13. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit; | Po [ ] |
| 14. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit; | Po [ ] |
| 15. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:<br>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;<br><br>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës . | Po [ ] |
| 16. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër; | Po [ ] Jo [ ] |
| 17. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit). | |
| 18. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :<br>a) çmimet;<br>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose<br>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës. | Po [ ] Jo [ ] |
| 19. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose këërkesat specifike të punëëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |
| 20. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |

C**: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të |

përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| 4. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 5. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 6. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. | Po [ ] Jo [ ] |
| | |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | |
| | |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>**Shënim**: nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:<br><br>Operatori ekonomik _____________________, do të mbështet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës _______________________, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse:_________, _________, __________ (nëse është rasti). | **Punonjës**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve<br><br>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br><br>4. Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>5. Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>6. Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>**Makineri e mjete**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË "Për disponimine mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)** |
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | | | | |

| **Kontratë furnizimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont sëfurnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj[2] nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. | |
| Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:<br><br>Z. ____________________________,me profesion_________________, i punësuar pranë | |

[2]Kjo deklaratë ka si qëllim garantimin e disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës objekt prokurimi sipas kërkesave të makinerive në DST

| | |
|---|---|
| shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>etj .,<br><br>i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. | |

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Firma ________________________**

**Vula_________________**

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të

Informacionittë deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- *Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit", nga verifikimi se cilës konstatohen se ndër të tjera të deklaruar janë edhe punonjësit e mëposhtëm:*

III.2.3. Referuar shkresës nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 570/6 prot datë 06.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *"Alko Impex General*

*Construction*" SHPK, e cila ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si më poshtë vijon:

*[.....] Lidhur nie Pikën IV të skualifikimit: 4. Nuk janë paraqitur Deshmite e penalitetit per personat e deklaruar ne Formularin e deklarimit si aksioner, administratorit apo drejtues të shoqërisë (sipas shtojces nr. 8). OE ankimues "ALKO-IMPEX General Construction" shpk, pretendon se ky skualifikim është i padrejtë pasi nga OE ankimues është paraqitur shtojca nr. 8, në përmbushje të kritereve kualifikuese, sipas përmbajtjes së kërkuar nga AK në DST. Në nenin 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në keto rregulla. Në interpretim të paragrafit të mësipërm, KSHA e konsideron të përmbushur kriterin e kushteve të përgjithshme të kualifikimit vetëm me paraqitjen e shtojcës nr. 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", duke i qëndruar strikt parashikimit të nenit 26, pika 6 të VKM nr. 285, e cila thotë se: 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kulalifikuar, i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion ose atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Për sa më sipër, KSHA e pranon këtë pretendim pasi në nënin e sipërcituar përjashtohet paraqitja e dokumentacionit për shkronjën C të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 255. (personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerët ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së [.....].*

III.2.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*" i cili parashikon shprehimisht se : *"1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit 11 kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër."*

Për këtë arsye, duke qenë se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i ngritur nga Autoriteti Kontraktor për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues e ka pranuar pretendimin në ankesë për këtë pikë, atëherë Komisioni Prokurimit Publik do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pikë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 570 prot., datë 16.03.2023 të operatorit ekonomik ankimues *"Alko Impex General Construction"* SHPK.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construction"* SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: "*Ne piken 2.3.9 "Makineri dhe Pajisje", Per makinerite e kerkuara nuk eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni i kerkuar sipas DST. Konkretisht:**1-** Kamionçina me targa AA618GM, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;* **2-** *Kamionçina me targa AA675PI, polica e sigurimit e skaduar me date 14.12.2022;* **3-** *Kamioni me targë AA93500, polica e sigurimit e skaduar me date 24.11.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;* **4-** *Kamioni me targë AA5I9RZ, certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;* **5-** *Kamioni me targë AA4I2VO, me siguracion të skaduar ne date 02.12.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022;* **6-** *Kamioni me targë AA125OV me siguracion të skaduar me date 02.12.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 17.12.2022;* **7-** *Autobitrumatriçe AA72IXG me certifikatë te kontrollit teknik të skaduar me date 21.12.2022;* **8-** *Mjetet ekskavator me goma, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi nderkohe qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë" si dhe Ligji Nr. 32/2021 "Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit" parashikojnë se, "mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim , çdo mjet me goma i lëvizshëm duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi" si dhe*

*“Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”.* **9-** *Mjeti Grejder, ka paraqitur vetëm akte zhdoganimi ndërkohë qe Ligji Nr.8378, Datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës Së Shqipërisë” si dhe Ligji Nr. 32/2021 “Për Sigurimin e Detyrueshëm ne Sektorin e Transportit” parashikojnë se, “mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave, subjekt i detyrimit për regjistrim, çdo mjet me goma i lëvizshëm duhet te jete i pajisur me leje qarkullimi” si dhe “Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”* në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________të operatorit ekonomik

 ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------<br>- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | --------------------------------------------------<br>---- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |

| | |
|---|---|
| Telefoni: | ------------------------------------------------------ |
| E-mail: | ----------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

**(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

| |
|---|
| Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar. |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

**TË KUALIFIKIMIT**

| Deklarata | Referencat (kur janë të zbatueshme) |
|---|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentacit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>____________________<br>____________________ | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]] |

| | |
|---|---|
| etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. | |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

| | |
|---|---|
| Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. | |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| |
|---|
| |

| Deklarata | Përgjigje |
| --- | --- |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: | ____________________________ |
| 21. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate; | Po [ ] |
| 22. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet; | Po [ ] |
| 23. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit; | Po [ ] |
| 24. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit; | Po [ ] |
| 25. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:<br>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;<br>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës . | Po [ ] |
| 26. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër; | Po [ ] Jo [ ] |
| 27. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit). | |
| 28. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :<br>a) çmimet;<br>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose<br>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës. | Po [ ] Jo [ ] |
| 29. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose këërkesat specifike të punëëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |
| 30. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |

C**: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të |

përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| 7. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 8. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 9. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. | Po [ ] Jo [ ] |
| | |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | |
| | |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>**Shënim**: nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:<br><br>Operatori ekonomik ____________________, do të mbështet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës ______________________, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse:_________, _________, __________ (nëse është rasti). | **Punonjës**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve<br><br>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br><br>7. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br>8. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br>9. Z. _________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ___________________,<br><br>**Makineri e mjete**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË "Për disponimine mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)** |
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |

| 6 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|

| **Kontratë furnizimi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont sëfurnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj[3] nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. | |
| Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:<br><br>Z. __________________________,me profesion________________, i punësuar pranë | |

[3]Kjo deklaratë ka si qëllim garantimin e disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës objekt prokurimi sipas kërkesave të makinerive në DST

| | |
|---|---|
| shoqërisë sonë, në rolin e ___________________, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. | |

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Firma ________________________**

**Vula_________________**

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të Informacionittë deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

III.3.2. Në shtojcën 7/2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*" pika 2.3.9 "*Kapaciteti teknik*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

***2.3.9.*** *Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

| NR | EMERTIMI I MAKINERIVE | NJESIA | SASIA | ME QERA/PRONESI |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | SKREPER | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 2 | ESKAVATOR 0.15 m3 | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 3 | ESKAVATOR ZINXHIR 0.5 m3 | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 4 | ESKAVATOR 0.5 m3 | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 5 | ESKAVATOR 1 m3 | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 6 | AUTOVETËSHKARKUES MBI 8 TON | Cope | 6 | ME QERA/PRONESI |
| 7 | KAMIONCINË | Cope | 3 | ME QERA/PRONESI |
| 8 | GREJDER | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 9 | RUL ME VIBRIM | Cope | 7 | ME QERA/PRONESI |
| 10 | AUTOBOT | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 11 | RUL ME KOMPRESOR | Cope | 2 | ME QERA/PRONESI |
| 12 | AUTOBITUMATRICE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 13 | ASFALTOSHTRUESE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 14 | BETONIERE 500 LITRA | Cope | 4 | ME QERA/PRONESI |
| 15 | VINC KULLE | Cope | 1 | ME QERA/PRONESI |
| 16 | VIBRATOR THELLESIE | Cope | 4 | ME QERA/PRONESI |
| 17 | FABRIKE ASFALTOBETONI | Cope | 1 | ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi |
| 18 | NYJE INERTESH | Cope | 1 | ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi |

***e)*** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*

***f)*** *Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe*

*dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënësit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.*

**g)** *Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 8.*

**h)** *Per Nyjen e materialeve inerte, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine, Ne rast se eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se nuk ka ne pronesi apo me qera Nyje te materialeve inerte duhet te paraqitet kontrata noteriale e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

**i)** *Për Fabrikën e asfaltobetonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata noteriale e qerase, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction" SHPK*, së bashku me deklaratën për disponimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve.
- Kamion me targë AAXXXRZ, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*
- Kamion me targë AAXXXVO, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme) , 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*

- Kamion me targë AAXXXOV, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*
- Autobitrumatrice me targë AAXXXXG, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*
- Kamionçin me targë AAXXXGM, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*
- Kamionçin me targë AAXXXOO, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.*

III.3.4. Në neni 2 "*Qëllimi i ligjit*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.5. Në neni 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik"* parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.6. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar*

*kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*
*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*
*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*
*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*
*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
***4.** Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
***5.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

III.3.7. Neni 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën".*

III.3.8. Në nenin 82 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht :

*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

*Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.*

*Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

*3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.*

*4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.*

*5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:*

*a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;*

*b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.3.9. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*" të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet se: "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*.

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [4]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

[4] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

*h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

*k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[5]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t΄i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*”

III.3.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “*Për prokurimin publik”* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se

autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se zotërojnë makineritë dhe pajisjet e duhura për zbatimin me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construction*" SHPK, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, të parashikuar në shtojcën 7/2 pika 2.3.9 në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve, Komisioni vëren se ky i fundit ka paraqitur në sistemin e prokurimeve publike SPE shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" në të cilën konstatohet se janë deklaruar mjetet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.9 të kapacitetit teknik, si dhe dokumentacionin respektiv për secilin mjetë konkretisht - Kamion me targë AAXXXRZ, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* - Kamion me targë AAXXXVO, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* - Kamion me targë AAXXXOV, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* - Autobitrumatrice me targë AAXXXXG, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* - Kamionçin me targë AAXXXGM, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* - Kamionçinë me targë AAXXXOO, 1- *Certifikata Pronësisë së Mjetit Rrugor, 2- Leja Qarkullimit, 3- Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore (e vlefshme), 4- Polica e Sigurimit (e vlefshme), 5- Foto të Mjetit.* Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, rezulton se vlefshmëria e *Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore dhe Policës së Sigurimit,* është me datë skadence përtej afatit kohor të dorëzimit të ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike, pra ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 02.11.2022, datë kjo e fundit për dorëzimin e ofertave dhe dokumentacionit shoqërues të ofertës në SPE, ç'ka do të thotë se dokumentacioni i sipërcituar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka qënë i vlefshëm, pra afati i *Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore dhe Policës së Sigurimit* kanë qënë të vlefshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumente të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për të përmbushur kriteret dhe përcaktimet e autoritetit kontraktor, pasi *Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore dhe Policës së Sigurimit,* të lëshuara nga organet kompetente, për kamionçinën me targa AAXXXGM, polica e sigurimit e skaduar me datë 14.12.2022; për kamionçinën me targa AAXXXPI, polica e sigurimit e skaduar me datë 14.12.2022; për kamionin me targë AAXXXOO, polica e sigurimit e skaduar me datë 24.11.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me datë 20.12.2022; për kamionin me targë AAXXXRZ, certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022; për kamioni me targë AAXXXVO, me siguracion të skaduar ne date 02.12.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 20.12.2022; për kamioni me targë AAXXXOV me siguracion të skaduar me date 02.12.2022 dhe certifikata e kontrollit teknik e skaduar me date 17.12.2022; - për Autobitrumatriçe AAXXXXG me certifikatë te kontrollit teknik të skaduar me date 21.12.2022, pra nga verifikimi i vlefshmërisë

së këtyre dokumenteve rezulton se ato nuk e kanë humbur vlefshmërinë në datën 02.11.2022, datë në të cilën autoriteti kontrakor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumente të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, për të përmbushur kriteret dhe përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë mënyrë, KPP referuar pretendimit të autoritetit kontraktor, pasi kreu verifikimet e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construstion*" SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se operatori ekonomik ankimues ka mundur të paraqesë në këtë procedurë prokurimi dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i përket vlefshmërisë së *Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore dhe Policës së Sigurimit* të cilat në datën e zhvillimit të procedurës nga autoriteti kontraktor me 02.11.2022, kanë qenë të vlefshme duke dëshmuar kështu, se plotëson kriterin në fjalë, si dhe duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kështu, autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë a-priori dhe në mënyrë sipërfaqësore, por të analizojë në themel dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë.

III.3.12. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 "*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*" të Ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" dhe nenin 36 "*Sigurimi i kontratës*", dhe nenin 108 "*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 "*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*" të LPP-së, si dhe nenit 36 "*Sigurimi i kontratës*", dhe nenit 108 "*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e punimeve do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Operatori ekonomik "*Alko Impex General Construstion*" SHPK" SHPK, me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses specifikimet teknike për produktet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construstion*" SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construstion*" SHPK për sa i përket arsyes së skualifikimit se: "*Shoqëria ka paraqitur 10 shoferët e kërkuar sipas DST, por pa dokumentacionin e plotë sepse mungonte certifikata nga ISHT-i për secilin prej tyre. Për 6 manovratoret e kërkuar nuk është paraqitur certifikata nga ISHT-i",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit"* në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________të operatorit ekonomik

_______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. **INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
| --- | --- |
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | ------------------------------------------------ |
| Numri NIPT/et: | -------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----------------------------------------------------- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ---------------------------------------------------- |
| E-mail: | --------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

**(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| Deklarata | Referencat (kur janë të zbatueshme) |
|---|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentacit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>____________________<br>____________________<br>etj.<br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]] |

| | |
|---|---|
| kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. | |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

| | |
|---|---|
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:<br>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]<br>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]<br>Lloji i dokumentit: [shkruajeni] |

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt: | ____________________________ |
| 31. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate; | Po [ ] |
| 32. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet; | Po [ ] |
| 33. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit; | Po [ ] |
| 34. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit; | Po [ ] |
| 35. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:<br>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;<br>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës . | Po [ ] |
| 36. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër; | Po [ ] Jo [ ] |
| 37. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit). | |
| 38. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :<br>a) çmimet;<br>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose<br>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës. | Po [ ] Jo [ ] |
| 39. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose këërkesat specifike të punëëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |
| 40. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart. | Po [ ] Jo [ ] |

C**: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

| Deklarata |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të |

përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| 10. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 11. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. | Po [ ] Jo [ ] |
| 12. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. | Po [ ] Jo [ ] |
| | |

**Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga | Po [ ] Jo [ ] |

| | |
|---|---|
| Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | |
| | |

**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>**Shënim**: nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë:<br><br>Operatori ekonomik ____________________, do të mbështet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës ______________________, i cili do të vërë në dispozicion _____ punonjës, (me profesionet përkatëse:_________, _________, __________ (nëse është rasti). | **Punonjës**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve<br><br>Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatese:<br><br>10. Z. ________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>11. Z. ________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br>12. Z. ________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>**Makineri e mjete**<br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete |

**C: DEKLARATË "Për disponimine mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt  tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

| **Në pronësi** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa** | **Nr. Lejes qarkullimit** | **Nr. Shasisë** | **Të tjera** |
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |

| **Me qira** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i Mjetit** | **Targa e mjetit** | **Nr. Lejes qarkullimit të mjetit** | **Nr. Shasisë së mjetit** | **Nr. Kont së qerasë (noterisë)** | **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)** |
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | | | | |

| Kontratë furnizimi | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit** | **Nr. Kont sëfurnizimit (noterisë)** | **Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)** | **Të tjera** | |
| 1. | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera**

| Deklarata | Përgjigje |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj[6] nën përgjegjësinë time të vetme se: | |
| Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti. | |
| Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:<br><br>Z. ________________________,me profesion_______________, i punësuar pranë | |

[6]Kjo deklaratë ka si qëllim garantimin e disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës objekt prokurimi sipas kërkesave të makinerive në DST

| | |
|---|---|
| shoqërisë sonë, në rolin e ____________________,<br><br>etj .,<br><br>i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. | |

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Firma ________________________**

**Vula_________________**

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të

Informacionittë deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

***Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

III.4.2. Në shtojcën nr. 7/2 "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*" në pikën 2.3.7 "*Kapaciteti Teknik*" në dokumentet standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë::

***ISHTE:***

***2.3.7.*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:*

- *Teknik Ndërtimi 3(tre)*
- *Specialist te pergjithshem Ndertimi 4( kater)*
- *Elektricist 2 (dy)*

- *Hidraulik  2 (dy)*
- *Karpentier 2 (dy)*
- *Hekurkthyes 2 (dy)*

*të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë te pakten për periudhen korrik - shtator 2022 dhe në vazhdim.*
*Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht* ***10 (dhjete) manovrator*** *si dhe* ***10 (dhjete) shofer*** *te mjeteve te renda.*
*Per manovratoret deshmite e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme dhe deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen korrik – shtator 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues*
*Per shoferet leje drejtimi e vlefshme deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libreze pune dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen korrik – shtator  2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.  Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

***BËHET:***

***2.3.7.*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:*
- *Teknik Ndërtimi    3(tre)*
- *Specialist te pergjithshem  Ndertimi   4( kater)*
- *Elektricist 2 (dy)*
- *Hidraulik  2 (dy)*
- *Karpentier 2 (dy)*
- *Hekurkthyes 2 (dy)*

*të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë te pakten për periudhen korrik - shtator 2022 dhe në vazhdim.*
*Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **6 (gjashte) manovrator** si dhe **10 (dhjete) shofer** te mjeteve te renda..*
*Per manovratoret deshmite e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme dhe deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen korrik – shtator 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen sëbashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues*
*Per shoferet leje drejtimi e vlefshme deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libreze pune dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen korrik – shtator 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction"* SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction" SHPK,* së bashku me deklaratën për disponimin e punonjësve të nevojshme për realizimin e punimeve dhe dokumentacionin e punonjësve.

III.4.4. Me shkresën nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 570/6 prot datë 06.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dsipozicion të Komisionit Prokurimit Publik, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "*Alko-Impex General Construction"* SHPK sipas kërkesës së bërë nga ana e autoritetit kontraktor më datë 07.02.2023, në lidhje me vërtetueshmërinë e kritereve të deklaruara në formularin përmbledhës

të vetëdeklarimit, nga verifikimi rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

1. Kontratë Pune datë 31.08.2021 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. E. G, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
2. Kontratë Pune datë 09.02.2022 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. C, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
3. Kontratë Pune datë 14.07.2020 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. B. M, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
4. Kontratë Pune datë 05.12.2020 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. S. A, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
5. Kontratë Pune datë 25.06.2022 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. B, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
6. Kontratë Pune datë 02.02.2022 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. B, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
7. Kontratë Pune datë 01.05.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. K, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
8. Kontratë Pune datë 11.11.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. M. G, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
9. Kontratë Pune datë 09.02.2021 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. F. V, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
10. Kontratë Pune datë 09.11.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. S. H, me dëtyrë shofer me Leje Drejtimi, Librezë Pune.
11. Kontratë Pune datë 03.06.2013 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. B. L, Eskavatorist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
12. Kontratë Pune datë 01.05.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. Sh, Eskavatorist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
13. Kontratë Pune datë 01.10.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. A. A, Buldozerist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
14. Kontratë Pune datë 02.07.2021 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. B. H, Automakinist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
15. Kontratë Pune datë 05.04.2018 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. D. B, Automakinist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
16. Kontratë Pune datë 02.07.2021 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. I. K, Automakinist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
17. Kontratë Pune datë 10.09.2019 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. V. P, Automakinist me Dëshmi Aftësie Profesionale.
18. Kontratë Pune datë 02.07.2021 lidhur midis punëmarrësit shoqërsië "Alko Impex General Construction" dhe punëmarrësit z. Xh. D, Automakinist me Dëshmi Aftësie Profesionale.

III.4.5. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin Publik*" përcaktohet se: *"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet 12 kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.".*

III.4.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" përcaktohet se: "*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin*

*përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari 23 përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës".*

III.4.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" përcaktohet se: "*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..*".

III.4.8. Në nenin 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*".

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin,*
*si më poshtë vijon:*
*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*
*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*
*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për*

*operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*
*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*
*h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*
*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*
*j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*
*k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*
*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*
*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*
*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*
*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

III.4.9. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma "ç" e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar,

parashikohet shprehimisht se: "*4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose [....]".*

III.4.10. Në nenin 6 "*Kontrolli teknik*", të ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, parashikohet:

*1. Pajisjet dhe instalimet elektrike para vënies në shfrytëzim duhet të kontrollohen në aspektin e sigurisë së jetës të njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga specialisti elektrik i caktuar posaçërisht nga subjekti furnizues me energji elektrike. Rezultatet e kontrollit paraqiten me shkrim dhe ruhen nga të dyja palët.*

III.4.11. Në nenin 7 "Detyrimet e punëdhënësit" të ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, parashikohet:

*1. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike, të vëna në dispozicion të punëmarrësve të ndërmarrjes ose të institucionit, të jenë të përshtatshme për punën që do të kryhet, duke garantuar sigurinë dhe shëndetin.*
*2. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike gjatë përdorimit të tyre të mirëmbahen nëpërmjet kryerjes së shërbimeve, të riparimeve dhe të pastrimeve në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat e rregulloreve teknike.*
*3. Çdo instalim elektrik duhet të ketë projektin përkatës. Çdo montim ose rikonstruksion në instalimet elektrike bëhet me projekt.*

III.4.12. Në nenin 8 "Informimi i punëmarrësve" të ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, parashikohet:

*1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme që punëmarrësi të marrë të dhënat e duhura dhe udhëzimet përkatëse për përdorimin e pajisjeve elektrike.*
*2. Të dhënat dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, përsa u përket:*
*a) kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve elektrike;*

*b) situatave anormale të parashikueshme;*
*c) përdorimit të mjeteve mbrojtëse individuale dhe kolektive për parandalimin e aksidenteve në punë;*
*ç) dhënies së ndihmës së parë mjekësore në rast aksidenti.*
*3. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesin.*

III.4.13. Në nenin 9 "*Formimi i punëmarrësve*" të ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, parashikohet:

*1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:*
*a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;*
*b) në rastin e riparimit, të modifikimit ose mirëmbajtjes së pajisjeve ose të instalimeve elektrike, punëmarrësit e interesuar duhet të kualifikohen në mënyrë të posaçme për t'i kryer këto detyra.*
*2. Punëdhënësi siguron që punëmarrësit të njihen me të dhënat e duhura dhe t'u bëhet instruktimi:*
*a) kur caktohen në vendin e punës;*
*b) kur në pajisjen elektrike që përdoret bëhen modifikime;*
*c) periodikisht, të paktën një herë në vit.*
*3. Të dhënat dhe instruksionet duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, në përputhje me nenin 8 pika 2.*
*4. Punëmarrësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për rreziqet që paraqesin për ta pajisjet elektrike që përdorin dhe për çdo ndryshim që ndikon në sigurinë e tyre.*

III.4.14. Në nenin 7 të ligjit Nr. 13/2013, datë 14.2.2013. "Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 8734, Datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, parashikohet:

Në nenin 9, shkronja "a" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:
"*a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.".*

III.4.15. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të

vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 "*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*" si dhe ka ngarkuar në SPE dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kritereve të kualifikimit të vetëdeklaruara në shtojcën 8, ku deklaron punonjësit, ndër të tjerë edhe punonjësit shofer dhe punonjësit e mjeteve të rënda sipas përcaktimit në kriterin e parashikuar në pikën 2.3.7 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ka deklaruar dhe ngarkuar dokumentacionin për punonjësit shofer së bashku me lejet e drejtimit dhe punonjësit manovrator së bashku me Dëshmitë e Aftësisë Profesionale. Nisur nga kushti i vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit se: "*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore dokumentacioni i mesiperm do te dorezohet prane AK jo me vone se* ***5 dite*** *nga publikimi i njoftimit te fituesit",* nëpërmjet shkresës nr 570/5 prot., datë 29.03.2023, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës të paraqitur nga shoqëria "*Alko Impex General Construction*" SHPK pranë KPP-së, në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre të depozituara nga operatori ekonomik pranë autoritetit, në përmbushje të kërkesave autoritetit kontraktor, të parashikuara në pikën 2.3.7 të kritereve të veçanta të kualifikimit "*Kapaciteti teknik*". Në datën 06.04.2023, me shkresën nr. 570/6 prot është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor dokumentacioni i shoqërisë "*Alko Impex General Construction*" SHPK, në përgjigje të shkresës nr. 570/5 prot., datë 29.03.2023 të KPP-së. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construction*" SHPK dhe dokumentacionit fizikisht të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për përmbushjen e kriterit 2.3.7 në lidhje me disponimin e 10 (dhjetë) shoferë dhe 6 (manovrator), operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumenatcionin për punonjësit e sipërcituar si Kontratë Pune, Leje Drejtimi, Librezë Pune dhe Dëshmi të Aftësisë Profesionale. Gjithashtu, ka paraqitur dokumentacion fizikisht pranë autoritetit kontraktor për punonjësit e sipërcituar.

Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se "*Se për punonjësit shofer dhe manovratorë nuk janë paraqitur certifikatat nga ISHT-i, b*azuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me veprimtarinë dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetror Teknik dhe Industrial, rezulton se ky institucion inspekton dhe certifikon pëmbushjen e standarteve rigoroze dhe rregulloreve për **1-** ***instalimet në sistemin hidrokarbur***, **2-** ***instalimin dhe funksionimin e pajisjeve nën presion në përdorim nga bizneset e qytetarët*** si dhe ***3- instalimin e përdorimin e pajisjeve elektrike të sigurta.*** . Duke iu kthyer kriterit 2.3.7 nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që të disponohet ndër të tjera edhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Ndërkohë që punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor si shoferët dhe manovratorët nuk kryejnë asnjë proces pune për asnjë nga përcaktimet e sipërcituara pra as për përdorimin e pajisjeve nën presion apo impianteve elektrike të specifikuar në ligjin nr 32/2016 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion*" dhe në ligjin nr 8734,

datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, në mënyrë që ata të pajisen me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Akoma më tej një rregullim më i detajuar gjendët në Urdhrin nr 5, datë 05.10.2017 "Për Miratimin e Rregullores për Procedurat e Miratimit dhe Mbikqyrjes së organeve Evropiane të Notifikuara dhe Organeve të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit" të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë kontekst është e paqartë dhe konfuze mënyra e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuara, kur punonjësit për të cilët është kërkuar dorëzimi i dëshmive të kualifikimit nuk kanë asnjë përputhje me veprimtarinë që ata ushtrojnë pra as përdorin pajisje nën presion dhe as nuk instalojnë impiante elektrike, duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret kriteri i mësipërm ka vendosur në kushte të pabarabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik në lidhje me vërtetueshmërinë e dëshmive të kualifikimit nga ISHTI kur punonjësit shofer dhe manovrator nuk ushtrojnë asnjë veprimtari si në instalimin e enëve nën presion ashtu dhe të impjanteve elektrike, të cilat rregullohen nga dispozitat ligjore të sipërcituara. Në këtë mënyrë Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autotiteti kontraktor ka përcaktuar një kriter joligjor dhe diskriminues duke kërkuar paraqitjen e disa certifikatave ose dëshmive të kualifikimit për punonjës që realisht nuk ushtrojnë veprimtari në ato fusha për të cilat kërkohet të lëshohen certifikatat apo dëshmitë e kualifikimit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi në mënyrë eksplicite se për punonjësit shofer dhe manovrator të paraqitet dëshmi kualifikimi nga ISHTI apo institucione ekuivalente, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion*" dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar. Në nenin 1 të "Objekti" të legjislacionit të sipërcituar është e specifikuar mjaft qartë fusha e veprimtarisë së tyre pra certifikimi i sigurisë nga rreziku elektrik dhe pajisjeve nën presion.

III.4.16. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur.
Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim

me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacion sektorial. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t'i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.4.17. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma "b" të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", sipas të cilit: *"Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;* nenit 98, pika 1, gërma "d" të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: *"Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj"*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma "b" të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, ku parashikohet se: *"[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" [...]",* në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesat për disponimin e dëshmive të kualifikimit nga ISHTI ose institucione ekuivalente për shoferët dhe manovratorët është një kriter evaziv dhe haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 32/2016 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion*" dhe në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 "*Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike*", i ndryshuar, mbi të cilin KVO ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, ndaj përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.5. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "*Alko Impex General Construction*" SHPK, dhe mbi pretendimet e ankimuesit për operatorët e tjerë pjesëmarrës Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit të mësipërm në pikën III.4, gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Albavia*" SHPK, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022*, me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

3. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1144/4 prot, datë 24.03.2023 për operatorin ekonomik "*Albavia*" SHPK, dhe vendimit të KSHA-së Nr. 1144/6 prot, datë 04.04.2023 për operatorin ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK.

4. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur*" me Nr. REF-*46203-10-17-2022*, me objekt: "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", me fond limit *220,320,000 (dyqind e njëzet milion e treqind e njëzet mijë),* lekë pa TVSh, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

5. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

6. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "*Albavia*" SHPK.

9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*Alko Impex General Construction*" SHPK.

10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Fiorent Zguro** | **Kreshnik Ternova** | **Anila Malaj** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2023.05.03 19:49:07 +02'00'